

DRAFT - DOKUMENTI KONSULTATIV

Për projektvendimin “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024 - 2030 dhe Planit të Veprimit”

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në kuadër të procesit të konsultimit të projektvendimit “Për miratimin e “Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024 - 2030 dhe Planit të Veprimit”, mirëpret sugjerimet e partnerëve socialë (organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve) nga qytetarët, ekspertë të fushës, nga të gjitha institucionet dhe subjektet e interesuara, organizata jofitimprurëse, shoqëria civile, të drejtat ose objekti i veprimtarisë të të cilave ka të bëjë apo ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga përcaktimet e kësaj nisme.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimet në portalin e “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”: do të realizohen në 20 ditë pune, duke filluar nga data 23.10.2024 dhe përfundojnë në datë 20.11.2024.

Si të përgjigjeni:

Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektvendimit, do të përcillen nga institucionet, organizatat, ekspertët, individët e interesuar, me anë të regjistrit elektronik në adresën <http://www.konsultimipublik.gov.al>.

Kontakti:

Znj. Eriola Kocileri, Koordinator për konsultimin publik në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit: eriola.kocileri@meki.gov.al

Znj. Igues Shehu, Specialist në Sektorin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit: ignes.shehu@meki.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

E-Konsultimi: në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”, do të realizohen në 20 ditë pune, duke filluar nga data 23 tetor 2024.

Sfondi i propozimit legjislativ

“Dokumenti i Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024 - 2030 dhe Planit të Veprimit”, ka për qëllim krijimin një vizion i qartë për të ardhmen, të zbërthyer në politika, prioritetet e objektiva strategjike dhe masa të mirëpërcaktuara, të cilat mund të zbatohen në mënyrë efektive, duke zhvilluar një sistem më të dobishëm inspektimi dhe menaxhimi të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

Gjithashtu, ka për qëllimin vazhdimin e reformave të fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, reflektimin e ndryshimeve që kanë ndodhur në botën e punës gjatë viteve të zbatimit të dokumentit të mëparshëm “Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2016 - 2020”.

Hartimi i “Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2024 - 2030 dhe të Planit të Veprimit”, është pjesë e Programit Analitik të Akteve të Këshillit të Ministrave nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për vitin 2024.

“Dokumenti Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024-2030” është në përputhje dhe bazohet në parimet, politikat dhe legjilacionin ndërkombëtar, evropian dhe kombëtar për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë:

- Strategjinë Globale e ONP/ILO-s për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024-2030
- Rezolutat e miratuara në Konferencën e 110-të Ndërkombëtare të Punës në lidhje me përfshirjen e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune si një e drejtë themelore, në Deklaratën e ONP/ILO-s të vitit 1998 mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë.
- Konventat Themelore të ONP/ILO-s për SSHP (Konventat 155 dhe 187)
- Kornizën e Strategjike së BE-së për SSHP 2021-2027
- Direktivën e Këshillit të BE-së 89/391/EEC e datës 12 qershor 1989 mbi futjen e masave për të inkurajuar përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në punë, e cila garanton kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në të gjithë Evropën, ndërsa shtetet anëtare lejohen të mbajnë ose vendosin masa më të rrepta.
- Ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, të ndryshuar, (gërma “a”, pika 2, neni 38)
- Përpjekjet dhe politikat kombëtare të drejtuara drejt arritjes së një mjedisi pune të sigurt dhe të shëndetshëm, si; Programi Vendor për Punën e Denjë për Shqipërinë 2023-2026, Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2023-2030 dhe Dokumenti Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2016-2020.

Propozimet

Hartimi dhe miratimi i këtij dokumenti politikash përmbush një nga rekomandimet e dhëna në “Raportin e Progresit për Shqipërinë, 2023”, për Kapitullin 19 “Politikat Sociale dhe të Punësimin”, në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, të prioritetëve të Qeverisë të parashikuara në “Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 - 2030”, (*miratuar me VKM nr. 88, datë 22.02.2023*) në “Strategjinë Kombëtare të Punësimin dhe Aftësive 2023 - 2030 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj, si dhe të Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore 2023 - 2024” (*miratuar me VKM nr. 173, datë 24.03.2023*).

Dokumenti i Politikave, identifikon dhe synon të arrijë katër rezultate kryesore:

- Realizimin e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune si një e drejtë themelore.
- Përmirësimin e mjedisit të punës duke zbatuar një qasje parandaluese, sistematike dhe të mirëkoordinuar për administrimin e shërbimeve të sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Ulja e shkallës së aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.
- Nxitja e një kulture parandaluese të sigurisë dhe shëndetit.

Modeli i ndërhyrjes dhe rezultatet e pritshme

Supozimet e marra parasysh

- Supozimi 1: Forcimi i institucioneve dhe rritja e kornizave normative do të çojë në përmirësimin e praktikave të sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Supozimi 2: Sistemet efektive të monitorimit dhe raportimit do të lehtësojnë identifikimin dhe zbutjen e rreziqeve dhe rreziqeve në vendin e punës.
- Supozimi 3: Mekanizmat e çertifikimit për profesionistët e SSHP në mjedise të ndryshme do të sigurojnë kompetencë dhe efektivitet në adresimin e çështjeve të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.
- Supozimi 4: Rritja e ndërgjegjësimit dhe kuptimit të të drejtave të sigurisë dhe shëndetit në punë do të çojë në pajtueshmëri dhe zbatim më të madh të masave parandaluese.

Rrugët e ndryshimit

- Forcimi i institucioneve dhe kornizave normative → Përmirësimi i zbatimit të politikave të SSHP → Mjedisi më i sigurt dhe më i shëndetshëm i punës.
- Sistemet e monitorimit dhe grumbullimi i informacionit → Kuptimi më i mirë i rreziqeve në vendin e punës → Zbatimi i masave parandaluese → Ulja e shkallës së aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.
- Sistemet e njohjes dhe raportimit për sëmundjet profesionale → Rritja e zbulimit dhe ndërgjegjësimit → Zbatimi i masave parandaluese → Ulja e shkallës së sëmundjeve profesionale.
- Mekanizmat e çertifikimit për profesionistët e SSHP → Kompetenca dhe efektiviteti i përmirësuar në adresimin e çështjeve të sigurisë në vendin e punës → Mjedisi më i sigurt dhe më i shëndetshëm i punës.

Rezultatet e pritshme

- Rritja e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për sigurinë dhe shëndetin në punë.
- Korniza normative të përmirësuar për sigurinë dhe shëndetin në punë.
- Krijimi i sistemeve të monitorimit për pasojat në vendin e punës.
- Forcimi i sistemeve të njohjes dhe raportimit për sëmundjet profesionale.
- Mekanizmat e çertifikimit për profesionistët e SSHP.

Rezultatet afatshkurtra

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe kuptimit të të drejtave dhe parimeve të sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Përmirësimi i mbledhjes dhe raportimit të të dhënave për aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës.
- Rritja e kapaciteteve të profesionistëve të SSHP përmes mekanizmave të çertifikimit.

Rezultatet e ndërmjetme

- Ulja e shkallës së aksidenteve në punë.
- Ulja e shkallës së sëmundjeve profesionale.
- Përputhshmëri e përmirësuar me rregulloret e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Rezultatet afatgjata

- Krijimi i mjediseve të sigurta dhe të shëndetshme të punës si një e drejtë themelore në nivel global.
- Rënie e konsiderueshme e vdekjeve dhe lëndimeve të lidhura me punën.

Pyetjet

Reagimet që priten janë të hapura dhe nuk parashikohet ngritja e pyetjeve specifike, të cilat kërkojnë përgjigje. Pyetje të mundshme mund të jenë: A pajtoheni me qartësinë e informacionit të paraqitur në dokumentin e politikave dhe çfarë do të propozonit shtesë për të përmirësuar cilësinë e tij? Si i vlerësoni përcaktimet në këtë Dokument të Politikave?